



Nr. Ref. BD-216/103

Në bazë të neneve 6.1.1, 6.1.2 dhe 15.2.4 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Nenit 2 të Rregullores nr.05/2022 - për përgjegjësitë e Bordit dhe Drejtorit Menaxhues të NSh Inex Sharr Planina në Brezovicë, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare në mbledhjen e mbajtur me datë 24 dhe 27 dhjetor 2024 nxjerr këtë:

## VENDIM

- I. Emërohet i Bordit të Përkohshëm i Ndërmarrjes Shoqërore Inex Sharr Planina Brezovicë me përbërjen si në vijim:
  1. Slobodan Staletovic – Kryesues
  2. Bujar Turjaka – Zëvendës Kryesues
  3. Fisnik Hyseni
  4. Ahmet Krasniqi
  5. Igor Ivkovic
  6. Hajdar Loku
  7. Dragisa Veljkovic
- II. Mandati i Bordit të Përkohshëm të Ndërmarrjes Shoqërore Inex Sharr Planina Brezovicë është një (1) vit duke filluar nga data e emërimit.
- III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

## ARSYETIM

Bordi shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit të Agjencisë për emërimin e Bordit të Përkohshëm Menaxhues të NSh Inex Sharr Planina në Brezovicë. Menaxhmenti këtë propozim e ka bazuar në rekomandimin e Komisionit përzgjedhës dhe në vlerësimin profesional të tyre.

Bordi u bazua në faktin se konstituimi i Bordit të Përkohshëm të ndërmarrjes Brezovica në përbërje të zgjeruar të zgjedhur përmes procedurës konkurruese përmes shpalljes së konkursit publik që do të ketë ndikim pozitiv në afarizmin e ndërmarrjes, prandaj Bordi i Agjencisë konsideron që për shkak të rëndësisë së zhvillimit të aktivitetit të ndërmarrjes pa pengesa dhe për shkak se Bordit të kaluar është shkarkuar dhe pas kësaj është shpallur konkursi publik për Anëtarë të Bordit të përkohshëm të NSH “Inex Sharr Planina - Brezovica”.

Pas zhvillimit të procedurave të tjera të konkursit si themelimi i Komisionit përzgjedhës, përzgjedhja e kandidatëve që i plotësojnë kushtet për intervistim, pastaj intervistimi, poentimi etj dhe në fund është bërë propozimi i kandidatëve të sipërcekur për emërim.

Duke marr parasysh të gjitha më lartë Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi ankesa mund të paraqitet pranë organeve kompetente në afat prej tetë (8) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

Prishtinë, më 27 dhjetor 2024.

  
  
Mentor Hyseni  
Kryesues  
Bordi i Drejtorëve  
Agjencia Kosovare e Privatizimit